

VENDIM
Nr. 48, datë 27.3.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPE GJADËR” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “GJADËR

NR. 1/1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2134 kw, HEC “GJADËR NR. 1/2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 4406 kw, HEC “GJADËR NR. 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2983 kw, HEC “GJADËR NR. 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3874 kw, HEC “GJADËR NR. 4”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5922 kw, HEC “GJADËR NR. 6”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 5619 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 24.938 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.3.2019 mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 195 prot., datë 28.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “SPE Gjadër” sh.p.k. është krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, në zbatim të detyrimit të nenit 8, të kontratës së koncesionit të formës “BOT”, nr. 10328 rep. dhe nr. 322 kol., datë 9.9.2013, të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, me cilësinë e Autoritetit Kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive “Ani” sh.p.k., “Rafaelo 2002” sh.a., “Junik” sh.p.k., “Vllaznimi” sh.p.k., “SPE Energy” sh.p.k., “EUES Energy” sh.p.k. për një afat 35-vjeçar nga hyrja në fuqi, ndryshuar me kontratën shtesë të koncesionit të lidhur midis MIE dhe “SPE Gjadër” sh.p.k. me nr. 328 rep. dhe nr. 176 kol., datë 17.6.2015, “Për një ndryshim në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve, në lumin Gjadër”.

Aplikimi i shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.1, pika 4.1.2; pika 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “d”, pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga

prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë, lista e personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca), germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Dokumentacioni teknik dhe grafik, neni 9, pika 4.1.3, germa “c” do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPE Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga “HEC Gjadër nr.1/1”, me kapacitet të instaluar 2134 kV, “HEC Gjadër nr.1/2”, me kapacitet të instaluar 4406 Kw, “HEC Gjadër nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 Kw, “HEC Gjadër nr. 3” me kapacitet të instaluar 3874 k Kw, “HEC Gjadër nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 Kw, “HEC Gjadër nr. 6”, me kapacitet të instaluar 5619 Kw, me kapacitet total të instaluar 24.938 kW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi